# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473535**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VIDEO/ Shikoni si shitej drogë në gjimnazet e Tiranës |
| ADRESA | `https://lapsi.al/video-shikoni-si-shitej-droge-ne-gjimnazet-e-tiranes-i1094570` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 11:12:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 11:10:34 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2307a6fd83ed607cfe338d00144fbdfdf3f784639da1c3261634429d48958a88` |
| TEKSTI | `0b47383f91eb2b08f3be5876f789f7982a46f4cb17f6fd85986cff11829a5e36` |
| PAMJA | `372b8f9e4147453d6b2128efd6cc668a41de5d0a76c0ac2073efe88c7a1c8586` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ed6703ad50a790951aed59890b9077859d348193bd6a996f02c1453896ce097a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdfe5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ed6703ad50a790951aed59890b9077859d348193bd6a996f02c1453896ce097a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# VIDEO/ Shikoni si shitej drogë në gjimnazet e Tiranës

LAPSI.AL • 27 SEPTEMBER 2026




Pamjet e filmuara me dron nga Policia e Tiranës tregojnë deri ku kishte depërtuar shpërndarja e drogës pranë shkollave të kryeqytetit; persona të survejuar afrohet deri te hekurat rrethues të shkollës për të kryejnë shkëmbimin me nxënësit.

Në pamjet e siguruara gjatë hetimit, shpërndarësi shihet teksa qëndron jashtë territorit të shkollës, ndërsa nxënësi afrohet nga ana tjetër e rrethimit. Mes tyre kryhet shkëmbimi përmes hekurave, pa qenë nevoja që shitësi të hyjë në ambientet e shkollës.

Pamjet janë pjesë e hetimit katërmujor të Policisë dhe Prokurorisë së Tiranës, që përfundoi me operacionin e koduar "Shkolla të Pastra", nëpërmjet të cilit u goditën disa grupe që, sipas policisë, shisnin lëndë narkotike pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, por edhe në zona të tjera të kryeqytetit.

Hetimi identifikoi 52 persona të dyshuar si të përfshirë në këtë aktivitet. Për 31 prej tyre u ekzekutua masa e sigurisë "Arrest në burg", 14 të tjerë janë shpallur në kërkim, ndërsa 7 persona ishin arrestuar gjatë katër muajve të hetimit.

Në disa raste droga transportohej me monopatina, taksi apo nëpërmjet shërbimeve delivery.

Gjatë hetimit dhe ekzekutimit të masave të sigurisë u sekuestruan 1 kilogram e 75 gramë heroinë, 1 kilogram e 265 gramë kokainë dhe 685 gramë kanabis. Policia sekuestroi gjithashtu një pistoletë, 90 fishekë, dy peshore elektronike, 12 automjete dhe 35 telefona celularë.

Operacioni "Shkolla të Pastra" vijon me kërkimin e 14 personave të tjerë të identifikuar gjatë hetimeve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë për shkak të vazhdimit të hetimit.

ide


Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsiu


Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTI TIRANA 24°C
KËMBIMI EURO 91.97

aktuale

22:06
Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit

21:31

Rama mbron projektin nga New Yorku: Zvërneci vlen miliarda, kundërshtarët "sharlatanë"

PROMO

TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku


## Të këshilluara



### WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë dollarëshe në Shqipëri

Një investigim i Wall Street Journal hedh dritë mbi rolin e ambasadores amerikane Kimberly Guilfoyle në promovimin e kompanisë greke "Aktor". Në mars, ajo takoi Kryeministrin Rama në Tiranë, e shoqëruar nga drejtori i kompanisë dhe lobisti i saj. Një muaj më vonë, u kthye për nënshkrimin e marrëveshjes 6 miliardë dollarëshe për furnizimin e Shqipërisë me gaz amerikan.



### Gjykata e Lartë refuzon tryezën e Ramës për pagat, Sadushi: Ndikon në vendimin e Kushtetueses

Gjykata e Lartë nuk do të marrë pjesë në tryezën e thirrur për nesër nga kryeministri Edi Rama me institucionet e drejt...



## Mbetet në burg Bledar Cafi, akuzohet për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal



### Rikthimi i kazinove, miliarda lekë fitime për vitin 2025

Pas nismës për mbylljen me ligj të lojërave të fatit nga 1 janari 2019, shoqëritë që e ushtronin këtë aktivit...



### Nëntë të arrestuar për krime lufte në Kosovë lidhur me rastin e 'Grupit të Intelektualëve'

Gjatë një operacioni të zhvilluar në Zubin Potok, nëntë persona janë arrestuar nën dyshime për krime lufte kund&eu...



### Goditen disa grupe që shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, arrestohen 31 persona

Pas katër muajsh hetime, Policia e Tiranës, në bashkëpunim me Prokurorinë e Tiranës, ka finalizuar operacionin e koduar "Sh...






**Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti, ka kaq shumë për të thënë**




Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit




Operacion i befasishëm i SPAK, arrestohet në Shkodër Bledar Cafi/ Rishpallet në kërkim Indrit Dokle




"Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri"




## FOTOLAJM/ Pankarta "Arrestoni Ramën" dhe mesazh për UÇK-në në "Air Albania"



### Përplasje me policinë te Libri Universitar, protestuesit vijojnë marshimin drejt bulevardit para Kryeministrisë

Marshimi i protestës së 119-të është shoqëruar me tensione mes qytetarëve dhe policisë në disa pika të Tiran&e...



### Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit

Kryeministri Edi Rama ka përfunduar vizitën në Shtetet e Bashkuara dhe pritet të kthehet nesër në Tiranë, pas pjesëmarr...



### Rama mbron projektin nga New Yorku: Zvërneci vlen miliarda, kundërshtarët "sharlatanë"

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuar...

## Me sytë katër



21:35

### "Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Komis...



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për ne! Meta vetëm i ndizte

20:36



PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

22:43

# SPORT

Të tjerë artikuj



12:00

## Maran nuk pajtohet me Gjimshitin: “Nuk jam surprizuar nga Bjellorusia”



23:17

### Shqipëria mposht Bjellorusinë, Gjimshiti, Ismajli dhe Muçi flasin pas ndeshjes



22:47

### Asllani e Muçi i japin fitoren e parë Maran në Nations League: Bjellorusia dorëzohet në Tiranë



15:01

### “Hesht, i hëngre dy”, Lukaku e provokoi, tërbohet Donnarumma: inati i së kaluarës në Itali-Belgjikë



14:34

### Manchester City fajtor për 114 shkelje financiare: mund të përjashtohet nga Premier League, çfarë ndodh me trofetë



11:30

### Asllani në dyshim, Mitaj ulet në stol: Maran ndryshon formacionin, ja si pritet të rreshtohet Shqipëria



10:51

### Maran debuton, por Bjellorusia do të jetë menjëherë vendimtare: italiani e ka nisur me dy humbje

# PAPARAZZI



12:00

## “Nuk e kam takuar kurrë”, gruaja tërheq akuzat për abuzim ndaj Jay-Z

Gruaja që akuzoi Jay-Z për abuzim seksual kur ishte vetëm 13 vjeçe ka tërhequr akuzat ndaj reperit dhe i ka kërkuar falje atij ...



### Pse u nda Gisele Bündchen nga Tom Brady? Libri i ri zbulon prapaskenat

22:26



### Sharon Stone kritikon reklamën e Sydney Sweeney: “Duhet të marrë përgjegjësi”

19:59



### A është për Tom Hiddleston? Taylor Swift habit fansat me këngën e re

17:48



### Dove Cameron dhe Damiano David i japin fund beqarisë

15:09




Themelues
Armand Shkullaku
Andi Bushati

Me dashuri nga
mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.